



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Nr. prot.12/2026

Datë: 27.02.2026

Me kërkesë të Sektorit për punë të Kuvendit Komunal të datës 27 shkurt/2026, për takimin e rradhës së Komitetit për Politikë e Financa, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim hartoi këtë:

INFORMATË

MBI PREGADITJET NDAJ EMERGJENCAVE NË KOMUNËN E GJAKOVËS

HYRJE

Qëllimi i kësaj Informatë, është që të bëhet përmbledhja dhe pasqyrimi i punëve, detyrave dhe aktiviteteve të realizuara në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, përmes së cilës paraqitet volumni i punës me statistikat e veqanta, analizat e punës dhe elaborimet mbi ecurinë e punëve dhe detyrave për të cilat është kompetente kjo Drejtori.

Pikësynimet tona gjatë realizimit të detyrave dhe përgjigjesive kanë qenë në aktivizimin e potencialit të Drejtorisë në marrjen e masave preventive të mbrojtjes dhe shpëtimit, në ofrimin e drejtpërdrejtë të ndihmës në parandalimin apo në zvogëlimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të mundshme.

Mbështetur Statutin e Komunës, në “Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera” nr. 04/L-027, të “Ligjit për Mbrojtje nga Zjarri” nr. 08/L-261, dhe dokumentëve tjerë strategjik si Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave dhe Planit të Reagimit Komunal dhe Kombëtar, të cilat përkufizojnë kompetencat e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në fushën e menaxhimit dhe koordinimit të situatave emergjente në komunë, kjo drejtori gjatë vitit 2025 ka realizuar një mori aktivitete konform njësive të saj organizative.

1. Aktivitetet kryesore të Drejtorisë

- Mbikqyrja e zbatimit të dispozitave ligjore dhe akteve tjera normative që rregullojnë funksionimin e sistemit të emergjencave civile në komunë;
- Njoftimi, paralajmërimi dhe alarmimi i qytetarëve për rreziqet e pashmangshme dhe dhënja e udhëzimeve për parandalimin dhe zvogëlimin e pasojave eventuale nga fatkeqësitë natyrore;
- Identifikimi, monitorimi dhe hulumtimi permanent i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive tjera që kërcënojnë komunën e Gjakovës;
- Reagimi ndaj situatave emergjente në komunë;
- Organizimi i gatishmërisë emergjente, krijimi dhe mirëmbajtja e formave tjera të gatishmërisë për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
- Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
- Trajnimi dhe aftësimi profesional për detyrat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
- Koordinimi me strukturat e nivelit lokal, ndërkomunal dhe qendror në funksion të zbatimit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
- Hartimi dhe azhurnimi i vlerësimit të rreziqeve dhe planeve operative për mbrojtje nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësit tjera;
- Programimi dhe planifikimi i mjeteve buxhetore dhe logjistike për realizimin i projekteve për parandalimin e rreziqeve, gatishmëri, për reagim në fatkeqësi dhe sanim të gjendjes pas fatkeqësisë;

2. Qendra Rajonale Emergjente -112 Gjakovë



Kjo njësi organizative ka bërë pranimin, selektimin, distribuimin dhe shkëmbimin reciprok ditorë i informatave për të gjitha llojet e rreziqeve për jetën e qytetarëve dhe të të mirave materiale me qëllim të marrjes së masave mbrojtëse në parandalimin dhe eliminimin e pasojave të mundshme.

Gjatë vitit 2025 janë pranuar gjithsejtë **16,837** thirrje nga qytetarët dhe subjektet tjera juridike, ndërsa janë menaxhuar **612** raste emergjente duke u koordinuar me strukturat reaguese si: Policia e Kosovës, Zjarrfikësit, FSK, urgjencën medicinale të QKMF dhe Spitalit Rajonal, Kryqin e Kuq, si dhe me Kompanit Publike tjera që operojnë në komunë K.R.U Gjakova, KEDS, K.R.M “Çabрати”, OIQ ,etj.

3. Preventiva dhe reagimi emergjent

- Verifikimi i gjendjes së krijuar lidhur me rrezikun që paraqet një shtëpi e pabanuar në rrugën “Mbreshtresha Teutë” nr. 61 ;



- Komisioni për verifikimin e gjendjes së krijuar lidhur me rrezikun e një shtylle nga druri në rrugën “Nënë Tereza” p.n ngjit me objektin e ri të Komunës së Gjakovës ;



- Verifikimi i objektit të vjetër në fshatin Ponoshec me urdheresë të Drejtorit të Drejtorisë së DMSH-së komisioni ka vendosur shiritat lidhur me rrezikun nga shembja e objektit ;



- Dalja në teren e komisionit për verifikimin e gjendjes lidhur me rrezikun që paraqet një objekt i vjetër i pa banuar në fshatin Zhub - Vogovë ;



- Me kërkesë të familjes Lan Musa nga fshati Batushë rr. "Kallavaj" nr. 48 verifikimi i gjendjes së shtëpisë së dëmtuar nga rrufeja ;



- Me kërkesë të palës është bërë verifikimi i gjendjes së kanalit kullues në fshatin Osek Hilë në rrugën “ Artan Zheli ”



4. Reshjet e shiut: Vlerësimi i gjendjes së krijuar me datë 18.11.2025 nga reshjet e shiu dhe monitrimi i vazhdushëm nga zyrtarët e Drejtorisë së DMSH-së ;

- Verifikimi i gjendje nga komisioni për konstatim dhe vlerësim të dëmit në biznesin e familjes Vjollca Bytyq B.I. ku e ushtron aktivitetin e prodhimit komisioni ka parë nga afër gjendjen e krijuar ;




- Komisioni për konstatim dhe vlerësim të dëmit ka parë afër dëmet në familjen Kushtrim Beqaj në fshatin Rracaj ;



- Rruga: “Mbretresha Teutë“ nr. 61 komisioni ka vendosur shiritat për rrezik eventual nga shembja e një shtëpie të pabanuar ;



- Rruga: “Bujar Roka” në drejtim të urës së Moglicës niveli i ujit ka qenë në kuota normale ;



- Komisioni për verifikim të gjendjes në fshatin Lipovec në kuadër të rreshqitjes së tokës në lagjen Halilaj ;



- Fshati Stubëll kanali i lumit Erenik në rrugën “Nimon Kadrija” komisioni ka vëzhguar nga afër situatën ;



- Fshati Batushë procka Çelia verifikimi i gjendjes nga zyrtarët e Drejtorisë ;



- Verifikimi i gjendjes në lumin Gusha ku prurjet kanë qenë në kuota normale ;




- Komisioni ka parë nga afër gjendjen e krijuar edhe në rrugën “ Gasper Karaqi “.



5. Intervenime preventive: Realizimi i punimeve emergjente në pastrimin e segmenteve të shtratit e lumit “Llukac” dhe të kanalit të ujit. Këto aktivitetete janë ndërmarr në kuadër të masave preventive për parandalimin eventual të vërshimeve apo zbutjen e pasojave të mundshme ;

- Rruga “Bekim Fehmiu”, lumi Llukac ;



- Fshati Ponoshec objekti me rrezikshmëri ;



- Rrejthojat në Njësinë e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit



6. Mbrojtja nga zjarri



Shërbimi Zjarrfikës gjatë vitit 2025 ka realizuar gjithsejtë **672** intervenime. Numri më i madh i tyre rrethë **513** raste kanë të bëjnë me zjarre, por duhet shtuar se përveç se në zjarre zjarrfikësit janë të obliguar të intervenojnë edhe në raste të vërshimeve, në aksidente komunikacioni, intervenime teknike dhe të një gamë të gjërë të shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën për qytetarët, institucionet, bizneset, etj.

Përkundër numrit të madhë të intervenimeve situata me zjarre ka qenë jo e mir ku kryesisht janë ballafaquar në shuarjen e zjarreve në sipërfaqet fushore **1.540** ha (dmth. në kullosa, barishte, shkurre, tokë bujësore, etj), e në sipërfaqe pyjore dukshëm më pak **26** ha.

➤ **Zjarret në zonat Malore**

- Vlenë për tu theksuar se në muaji **Korrik - Gusht** të vitit 2025 në kuadër të parandalimit të zjarreve në zonat malore Njësia e Zjarrfikësve në Gjakovë është mobilizuar me personel prej 25 zjarrfikës në shuarjen e zjarreve në fshatrat si në Vraniq, Bardhasan dhe Demjan në ndihme ka dalur edhe Njësitë e Reagimit nga Komunitatet fqinjë me mjete dhe paisje kundër zjarrit dhe me personel ;



Gjatë vitit 2025 kemi evidentuar 7 humbje jete duke asistuar në tërheqjen e trupit e 1 të vdekuri në rrugën “ Musa Zajmi ”, 3 fëmijë në fshatin “ Jabllanicë ”, 1 person i tërhekur nga NJPZSH te ura “ Fshajtë ”, 1 në fshatin “ Vogovë ” aksident komunikacioni dhe 1 zjarrfikës i vdekur në detyrë aksident komunikacioni.

Statistika vjetore të intervenimeve

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int.tjera janar-dhjetor 2025														
2025	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rejsh	Të lënduar			Të vdekur			Githsejt
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot	
Janar	30	18	6	1	4		1					3		30
Shkurt	25	20	2		3							1		25
Mars	64	58	3	1	2				4					64
Prill	31	19	5	4	3				8			1		31
Maj	30	19	4	7										30
Qershor	59	49	7	2	1				1					59
Korrik	135	116	10	9	0	0	0	0	0	0	1	0	0	135
Gusht	122	115	6	8	2	0	0	0	0	0	0	1	0	122
Shtator	61	47	11	2	2	0	0	0	0	0	0	1	0	61
Tetor	24	18	5	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	24
Nëntor	29	10	9	9	1	0	0	0	0	0	0	0	0	29
Dhjetor	31	24	2	3	2	0	0	0	0	0	0	0	0	31
Gjithsejtë	641	513	70	47	20	0	1	0	13	0	1	7	0	641

7. Buxheti dhe mbështetja logjistike

Buxheti i Drejtorisë për v. 2025 është menaxhuar në këto linja dhe shpenzueshmëria e tij ka qenë pothuaj se 100 % .

Planifikimi i buxhetit dhe shpenzueshmëria për v.2025

#	Gjithsejtë/€	Paga dhe mëditje/€	Investime kapitale/€	Mallëra dhe Shërbime/€	Shpenzime komunale/€
	511,999.99	391,999.99	00,0	100,000.00	20,000.00

- Borxhet e bartura në v. 2026 kanë qenë gjithsejtë 10,818.28 € prej të cilave 9,792.44 € në mallëra - shërbime dhe 1,025.84 € shpenzime komunale. Këto borxhe kanë qenë reale dhe të pashmangshme si pasojë e shpenzimeve të krijuara në nëntor-dhjetor/2025. Pothuaj se në asnjë pozicion buxhetor nuk kemi pas tepricë të mjeteve, që nënkupton se planifikimi dhe dinamika e shpenzimeve nga ana e Drejtorisë kanë qenë reale dhe e balancuar.

Me projeksionin buxhetor për v. 2026, nga pozicioni mallëra - shërbime nuk do të ketë ngritje por do të jetë i njëjti nga viti i kaluar si në Mallëra Shërbime 100,000.00 € dhe Komunalit 20,000.00 € edhe pse realisht kërkesat në këtë drejtim janë dukshëm më të mëdha.

8. Furnizimi me uniforma verore dhe dimërore për personelin zjarrfikës ;

Njësia e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit gjatë viti 2025 është furnizuar me “ **Uniforma verore dhe dimërore për personelin zjarrfikës** ” LOT - I në vlerë 21,420.00 € nga pozicioni mallëra dhe shërbime.



9. Trajnimet dhe koordinimi me strukturat e sigurisë

- Trajnim për ngritjen e kapaciteve në komunikim strategjikë dhe mardhënie me publikun e organizuar nga AME-OSBE pjesëmarrës Drejtori dhe Udhëheqësi i Sektorit ;
- Trajnim mbi reduktimin e barrës administrative e organizuar nga GIZ-Gjerman e financuar nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Gjermane pjesëmarrës dy zyrtarë të Drejtorisë ;
- Takim pune me Giz-Gjerman Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim lidhur me pikat kritike në komunë e Gjakovës pjesëmarrës një zyrtar ;
- Takim pune me Giz-in Gjerman lidhur me plotësimin e dokumentacionit lidhur me hartimin e dokumentin për vlerësimin të rrezikut pjesëmarrës tre zyrtarë të Drejtorisë ;
- Trajnim nga OSBE me temën Trajnimi për marrëdhënie me publikun dhe komunikim me media për njësinë zjarrfikëse pjesë marrës Drejtori dhe Udhëheqësi i Sektorit ;



10. Punët dhe detyrat tjera teknike administrative

- Hartimi i planeve dhe raporteve mujore periodike dhe vjetore të Drejtorisë;
- Vlerësime, konstatime, analiza dhe statistika dhe shkëmbimi i tyre me strukturat e reaguesve të parë në komunë dhe atyre të dytë të nivelit qendror, e sidomos me ato që janë përgjegjëse për menaxhimin e emergjencave dhe të mbrojtjes dhe sigurisë.
- Punëtori lidhur me procedurat standarte të operimit për masat disiplinore pjesë - marrës një zyrtarë i Dmsh-së ;
- Është bërë furnizimi me çanta shpinore për shuarjen e zjarrit nga Operatorit ekonomik në vlerë e planifikuar 4,560.00 €
- Furnizimi me uniforma verore dhe dimërore për njësinë e zjarrfikëseve dhe shpëtimit në vlerë e planifikuar 21,420.00 €
- Planifikimi i tenderit për dokumentit hartimin e planit të dokumentit për vlerësimin e rrezikut për Komunën e Gjakovës kontrata “Shërbime Konsulente” në vlerë 7,200.00 €
- Kontrata për Intervenimeve Emergjente nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim është paraparë për tre vite në vlerën 104,000.00 €
- Menaxhimi i performancës së Drejtorisë dhe përcaktimi i mënyrës së ngarkimit të dokumentacionit në Web-faqen e Ministrisë së Pushtetit Lokal MAPL ;

Arhiva: Gjatë kësaj periudhe raportuese, kjo Drejtoria ka pranuar dhe trajtuar gjithsejtë **47** lëndë, prej të cilave 24 janë miratuar, 6 janë transferuar tek drejtoritë përkatëse, 9 lëndë interne dhe 8 lëndë janë refuzuar.

JU FALEMINDERIT

